

PREFEKTURA DIBËR

Ardhur

Nr. 668 dt 24.07.25



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

2793

Nr. _____ Prot

24 07

Peshkopi, më _____ 2025

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Dibër


Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr. 31

Datë: 22.07.2025 si dhe projekt-vendimin nr.04 Datë 10.07.2025

“ PËR TRAJTIMIN ME SUBVENCIONIN E QIRASË ”

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari i Këshillit Bashkiak





2793/28/07/25

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.668/1 prot.

Peshkopi, më 28.07.2025

Lënda: Për vendimin nr.31, datë 22.07.2025 të Këshillit të Bashkisë Dibër.

BASHKISË DIBËR
KËSHILIT BASHKIAK DIBËR

DIBËR

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar neni 16, pas verifikimit për efekt ligjshmërie të vendimit të Këshillit të Bashkisë Dibër nr.31, datë 22.07.2025 “*Për trajtimin me subvencion të qerasë*”, konstatova se:

Akti administrativ objekt verifikimi dhe shqyrtimi bën pjesë në kategorinë e akteve me karakter individual, për pasojë nuk është në kompetencë të Prefektit të shprehet për ligjshmërinë e kësaj vendimmarrje.

Hyrja në fuqi e akteve administrative të kësaj natyre, bëhet sipas parashikimeve ligjore të përcaktuara në nenin 55/6 të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

PREFEKTI

Nexhbedin SHEHU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr. 31 Datë 22.07.2025

“ PËR TRAJTIMIN ME SUBVENCIONIN E QIRASË”

Mbështetur në nenin 8,pika 2,nenin 9,pika 1, nënpika 1.1, shkronja “a” dhe “b”, nenin 24, pika 2, neni 55, pika 2 dhe 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, nenit 77, pika 10 të ligjit nr.22/2018 “Për strehimin social”, Vendimin nr.574,datë29.08.2012,te Keshillit te Ministrave “Per percaktimin e dokumentacionit,qe duhet te paraqese familja per tu strehuar sipas njerit prej programeve sociale te strehimit,dhe afateve e te procedurave te miratimit nga organet e qeverisjes vendore VKM nr.459 datë 03.07.2019 “Për rregullat per administrimin e kerkesave te Njesive qeverisjes vendore per fonde nga buxheti I shtetit per subvencionimin e qirase ose uzurfruktit, menyren e financimit te subvencionit,monitorimit dhe bashkepunimin ndermjet njesive te vetqeverisjes vendore dhe ministries pergjegjese per strehimin” referuar shkresesnr.253 prot. date 19.05.2025, shkreses nr.79 prot date 26.05.2025. Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës **22.07.2025** me 16 vota pro, 0 kundër dhe 0 apstenim:

VENDOSI:

1. Të miratojë trajtimin me subvencionin e qirasë për familjet si më poshtë :

Emer	Atesia	Mbiemer	Kategoria	Perberja familjare	Struktura e apartamentit	Vlera e qerases/ lek/muaj
Arif	Vexhi	Kurti	PAK	6	2+1	15,000
Violeta	Ibrahim	Gjoni	Ndihme ekonomike	1	gasoniere	6,000
Fllanxa	Ramiz	Elezi	Ndihme ekonomike	1	gasoniere	6,000

2. Kohëzgjatja e pagesës së qirasë për familjen e përcaktuar në pikën 1, do të jetë deri në fund të muajit Janar 2026.
3. Për familjen, e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, kryerja e pageses do të kryhet pasi të dorëzohet numri i llogarisë së qiradhënësit pranë Drejtorise Ekonomike, referuar kontratës së qerasë noteriale.
4. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohen Drejtori Ekonomike, Drejtoria Juridike e Prokurimeve dhe Pronave .

5. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Diber.
6. Vendimi u shpall me datë **22.07.2025**.

Kryetare e Këshillit Bashkiak

Irimi SHEHU





REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA DIBER
DREJTORIA JURIDIKE E PROKURIMEVE DHE PRONAVE

PROJEKT – VENDIM

Nr. 01, date, 10 / 07 / 2025

“PËR TRAJTIMIN ME SUBVENCIONIN E QIRASË ”

Mbështetur në nenin 8, pika 2, nenin 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “ b”, nenin 24, pika 2, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 77, pika 10, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, vendimin nr. 574, datë 29.08.2012, të Këshillit të Ministrave “ Për përcaktimin e dokumentacionit, që duhet të paraqesë familja për t’u strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit, dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”, VKM nr.459, datë 3.7.2019 “ Per rregullat per adminsitrimin e kerkesave te Njesive te qeverisjes vendore per fonde nga buxheti i shtetit per subvencionimin e qirase ose uzufuktit, menyren e financimit te subvencionit, monitorimin dhe bashkepunimin ndermjet njesive te veteqeverisjes vendore dhe ministrise pergjegjese per strehimin” referuar shkreses nr. 253 prot date 19.05.2025, shkreses nr.79 prot date 26.05.2025 kryetari i bashkise ne mbledhjen këshillit bashkiak te dates _____._____.2025

PROPOZON :


1. Të miratojë trajtimin me subvencionin e qirasë per familjet si me poshte :

Emer	Atesia	Mbiemer	Kategoria	Perberja familjare	Struktura e apartamentit	Vlera e qerasc/ lek/muaj
Arif	Vexhi	Kurti	PAK	6	2+1	15,000
Violeta	Ibrahim	Gjoni	Ndihme ekonomike	1	gasoniere	6,000
Fillanxa	Ramiz	Elezi	Ndihme ekonomike	1	gasoniere	6,000


2. Kohëzgjatja e pagesës së qirasë për familjen e përcaktuara në pikën 1, do të jetë deri ne fund te muajit Janar 2026.
3. Për familjen, e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, kryerja e pageses do të kryhet pasi të dorëzohet numri i llogarisë së qiradhënësit pranë Drejtorise Ekonomike, referuar kontrates te qerasc noteriale.

4. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohen Drejtoria e Ekonomike, Drejtoria Juridike e Prokurimeve dhe Pronave .
- 5 . Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Diber.

P/Sektorit të Pronave dhe Strehimit
Gazmend Miftari



KRYETARI I BASHKISE



Drejtori Juridik
Ismet Saraçi



Peshkopi, më 07.07.2025

RELACION

“PËR TRAJTIMIN ME SUBVENCIONIN E QIRASË TË DISA FAMILJEVE NË NEVOJË, QË NUK MUND TË PËRBALLOJNË QIRANË E TREGUT TË LIRË”

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”, të ndryshuar, vendimit nr. 384, datë 12.6.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutur strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, shpenzimet mesatare referuar shkresës së MEKI nr. 12836 Prot., datë 13/11/2024, adresuar Bashkisë Dibër, “Për vlerësimin e nivelit të të ardhurave mesatare të familjeve”, të dhëna që do të përdoren për vlerësimin e nivelit të të ardhurave të familjeve sipas nenit 2, pika 45 ligjit “Për strehimin social”, vendimit nr. 02, datë 15/01/2025, të Këshillit Bashkiak Dibër “Për miratimin e nivelit të qirasë mesatare në treg të lirë, sipas strukturave të apartamenteve”. Me kërkesën nr. 79 prot., datë 26/05/2025, të Njesisë Administrative Kastriot kërkohet strehimi i familjes së Z. Arif Kurti pasi kushtet e strehimit, ekonomike dhe sociale në të cilat kjo familje ndodhet nuk mund të përballojë pagesën e qirasë dhe kërkesën nr. 253 prot., datë 19/05/2025 të Njesisë Administrative Maqellarë, kërkohet strehimi i Znj. Violeta Gjoni ku nga verifikimi i kryer nga ana e njësisë është konstatuar se ajo ndodhet në kushte emergjente për strehim, pasi ajo qendron jashtë prej kohësh. Pasi këto raste janë marrë në shqyrtim nga Sektori i Strehimit, këto familje janë asistuar nga punonjës të këtij sektori, që të paraqesin aplikimin nëpërmjet portalit e-albania dhe janë ndihmuar në plotësimin e të gjithë dokumentacionit përkatës për të përfutur strehim. Referuar kushteve emergjente për strehim, kushteve ekonomike dhe sociale në të cilat këto familje ndodhen, bazuar kontratës noteriale të qirasë, kërkohet miratimi i subvencionimit të qirasë të këtyre familjeve sipas të dhënave mëposhtë:

Bashkia Dibër

Tabele nr.1. Llogaritja e masës së subvencionimit të qirasë

(në lekë)

Nr	Emri, Mbiemri	Kategoria sipas nenit 16, të ligjit nr.22/2018, i ndryshuar	Për çfarë familjeje	Struktura e apart.	Shprehja e apart.	Qiraja mes. e apart. në treg për strukturën që i takon familjes	Të ardhurat familjare mujore	Kategoria sipas pikës 45, enenit 2, të ligjit nr.22/2018, i ndryshuar	Aftësi përballuese sipas nenit 3 të ligjit	Qiraja që përballohet me (h*1)	Subvencioni në muaj (a-b)	Subvencioni në muaj që mbulohet nga bashkia (j*100%)	Shuma që kërkohet nga buxheti (l-m)
a	b	c	d	e	f	g	h	i	j	k	l	m	n
1	Arif Vexhi Kurti	PAK, Ndihmë Ekonomike	6	3+1	110	15.000	0	“ç”	0	0	15.000	15.000	0
2	Violeta Ibrahim Gjoni	Ndihmë Ekonomike	1	Garsio nerë	50	6.000	0	“ç”	0	0	6.000	6.000	0
3	Filanza Ramiz Elezi	Ndihmë Ekonomike	1	Garsio nerë	54	6.000	0	“ç”	0	0	6.000	6.000	0

Sektori i Pronave dhe Strehimit

Përgjegjës

Specialist

Specialist

Gazmend Miftari

Xhesika Rama

Mentor Bitri